



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 116, Datë 27.07.2017

MBI

**KËRKESËN PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE NR. 148, DATË 26.12.2014
PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR VITIN 2015.**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5 dhe 6 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 8 dhe 16 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi rishikimin e vendimit të ERE nr. 148, datë 26.12.2014 për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015;

Konstatoi se:

- Në ERE me shkresën nr. 525 prot., datë 24.04.2017 është protokolluar kërkesa e Telecom Albania sh.a., Vodafone Albania sh.a., Plus Communication sh.a. dhe Albtelecom sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 148, datë 26.12.2014 të ERE, ku të shtohet një kategori e veçantë në këtë vendim për operatorët e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe të zbatohen tarifa për këta sipërmarrës me nivele më të ulëta se tarifat që aplikohen aktualisht dhe në çdo rast jo më shumë se 9.5 lekë/KWh.
- Me vendimi nr. 148, datë 26.12.2014 është vendosur: “për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.
- Me vendimin nr. 190, datë 22.12.2016 është vendosur mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit nr. 13, datë 16.02.2016, vendimit nr. 128, datë 29.07.2016 të Bordit të ERE-s deri në 31.03.2017.
- Me vendimin nr. 52, datë 06.04.2017 është vendosur mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017.
- Neni 16, pika 5 e ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon që: “Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në

marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”.

- Kërkesa për rishikimin e vendimit të ERE nr. 148, datë 26.12.2014 është përcjellë jashtë afateve të parashikuara në ligj e si e tillë është parashkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërive Telecom Albania sh.a., Vodafone Albania sh.a., Plus Communication sh.a. dhe Albtelecom sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 148, datë 26.12.2014, *“Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.*
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE
Adriatik BEGO